



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr. 578 Prot.

Gjirokastrë, më 03.05.2023

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në shkollën verore në Universitetin e Prishtinës

Universiteti i Prishtinës organizon shkollën verore ndërkombëtare për studentë nga e gjithë bota. *Shkolla verore PISU 2023* do të mbahet në Prishtinë nga data 3 deri më 14 korrik 2023.

Gjatë periudhës 2-javore do të ofrohen 14 kurse cilësore me literaturë moderne që lidhen me fusha të ndryshme të studimit si: shkencat sociale, drejtësia, ekonomia, artet, mjekësia, etj. Diskutimet apo panelet publike të cilat ngrenë debate socio-ekonomike do të jenë pjesë e shkollës verore. Komunikimi në të gjitha kurset do të zhvillohet në gjuhën angleze.

Pjesëmarrësit që do të ndjekin të paktën 80% të programit dhe do të kalojnë provimin, do të pajisen me certifikatë dhe kredite.

Për përzgjedhjen e kurseve klikoni katalogun: <https://drive.google.com/file/d/1P-IT0j0Oh38D3GnvkFcdHgxplqfYD8hT/view?usp=sharing>

Përveç studimit në fushat e interesit, pjesëmarrësit do të mund të bëhen pjesë e ekskursioneve, programeve kulturore dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare për të zbuluar bukuritë e Kosovës.

Aplikimet janë të hapura deri më 26 maj 2023.

Për informacione të mëtejshme mund të kontaktoni:

Email: uvp@uni-pr.edu.

FACEBOOK: <https://www.facebook.com/prishtinasummeruniversity>

REKTOR

Prof. dr. Bektash MEMA

